

## KONTRATE SHITJE KUOTASH

Bazuar ne:

a- bazuar ne nenet 705 e vijues mbi shitjen KC

b- N.47 i ligjit 7638 date 19.11.1992 mbi Shoqerite Tregtare

Sot me date 17/09/2001, ne Tirane, ndermjet ortakeve te shoqerise «BIOMEDIC» shpk

- 1- Mitro TODHE,
- 2- Aleksandra GJONI
- 3- Besnik XHINDOLE
- 4- Enver LEKA

Eshte rene dakort si me poshte vijon:

Shoqeria «BIOMEDIC» shpk eshte rregjistruar sipas vendimit n. 21934 date 08.09.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane. Sipas vendimit n. 21934/1 date 31.01.2001 gjykata e rrethit Tirane ka pranuar kate raport kuotash ne kapitalin e shoqerise: Mitro Todhe – 50%, Aleksandra Gjoni – 15%, Besnik Xhindole – 20% dhe Enver Leka – 15%.

Me ane te vendimit n.1 date 17.09.2001 te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise eshte vendosur shitja e kuotave te ortakeve Aleksandra Gjoni, Besnik Xhindole dhe Enver Leka tek ortaku Mitro Todhe.

**OBJEKTI I KONTRATES:** Me ane te kesaj kontrate ortaket Aleksandra Gjoni mbajtese e 15% te kuotave, Besnik Xhindole mbajtes i 20% te kuotave dhe Enver Leka mbajtes i 15% te kuotave, shesin kuotat e tyre per nje total prej 50% tek ortaku Mitro Todhe dhe bleresi ne fjale pranon t'i bleje keto kuota, kundrejt ketyre kushteve :

**CMIMI KONTRAKTOR :** Kuotat e shitura kapin nje vlere ose nje cmim kontraktor prej 50.000 lekesh, dhe bleresi pranon t'a levroje lirisht kete cmin.

**GARANCITE:** Pala shitese e garanton palen blerese se kuotat e shitura – objekt kontrate jane te lira nga te gjitha debitet, pretendimet e te treteve mbi to, si dhe nga cdo barre pengu apo hipoteke.

**EFEKTET JURIDIKE:** Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe depozitimim e saj ne rregjistrin tregtar te gjykates se rrethit Tirane, ortak i vetem i shoqerise «BIOMEDIC» shpk do te mbetet Z. Mitro Todhe me 100% te kuotave.

**DITA EFEKTIVE E KONTRATES:** Kjo kontrate hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimimit te saj. Kontrata eshte e vlefshme ne rast se nenshkruhet para noterit.

Sa me lart, lexohet nga palet dhe nenshkruhet lirisht prej tyre:

### PALET KONTRAKTORE

SHITES

ALEKSANDRA GJONI

BESNIK XHINDOLE

ENVER LEKA

BLERES

MITRO TODHE

